



VENDIM

Nr. 22 Datë 24.02.2012

**PER MIRATIMIN E RREGULLORES SE LIDHJEVE TE REJA,
MARREVESHJES SE LIDHJES SE RE DHE FORMULARIT TE
APLIKIMIT PER LIDHJE TE RE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “g”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës IV, të Kodit të Shpërndarjes të miratuar me vendimin nr. 100, date 26.8.2008, të Bordit të Komisionerëve si dhe pikës 7.1.5 dhe 12 të Metodologjisë së Llogaritjes të Tarifës së Shpërndarjes të miratuar me Vendimin nr. 79, date 26.6.2008, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.02.2012, mbasi shqyrtoi draftin e Rregullores së Lidhjeve të Reja, Marrëveshjes së Lidhjes së Re dhe Formularin e Aplikimit për Lidhje të Re

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores së Lidhjeve të Reja, Marrëveshjes së Lidhjes së Re dhe Formularin e Aplikimit për Lidhje të Re. (Aktet bashkëlidhur).
2. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të ERE nr. 17, date 19.12.2001, ”Për miratimin e Udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj“.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Sokol RAMADANI